




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



**Emri i Biznesit:** G2 MEDIA KS SH.P.K  
**Numri Unik Identifikues:** 811901843  
**Pronari:** G2 MEDIA SH.P.K  
**Numri Unik i Identifikimit të Subjektit:** K71616017T  
**Pronar:** Gener 2 Sh.p.k.  
**Numri Unik i Identifikimit të Subjektit:** K58615301M  
**OSHMA:** "A2 CNN Kosovë"  
**Personi i autorizuar:** Zana Luzha Kelmendi  
**Adresa:** Rr Hilmi Rakovica, Nr 6, Prishtinë



## VENDIM

për licencimin e Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audiovizuale "A2 CNN Kosovë" për transmetim përmes rrjetit të operatorëve të shpërndarjes – me seli në Prishtinë

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2021/01 e plotësuar dhe ndryshuar, ka hyrë në fuqi më 17 dhjetor 2021, përmes së cilës KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Audio dhe Audiovizuale të cilët transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes, e që do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtjesore dhe t'i transmetojnë ato përmes cilit do operatorë të shpërndarjes.
3. Më datën 26 janar 2023, kandidati "A2 CNN Kosovë", ka parashtruar aplikacionin për licencë të KPM-së për të vepruar si ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) për transmetim përmes operatorit të shpërndarjes, me përmbajtje tematike (informative).
4. Për shkak të mungesës së kuorumit për vendimmarrje të Komisionit të Pavarur të Mediave, nga data 15 tetor 2022 deri më datën 6 qershor 2023, kërkesa e kandidatit "A2 CNN Kosovë", nuk ka arritur të shqyrtohet me kohë.




### Arsyetim

5. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së OSHMA “A2 CNN Kosovë”, në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së dhe në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2021/01.
6. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së “A2 CNN Kosovë” ka ofruar të dhënat e nevojshme për vlerësim të aplikacionit. Materialet e ofruara si pjesë e aplikacionit konsiderohen të qëndrueshme sa i përket skemës programore në përgjithësi; të dhënat rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale, përfshirë edhe të dhënat rreth qëndrueshmërisë financiare.
7. Sipas Nenit 15, paragrafit 5 të Rregullores KPM-2021/01, kandidati për licencë të KPM-së “A2 CNN Kosovë”, duhet të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM, në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, si dhe me ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
8. Komisioni vlerëson se, kandidati “A2 CNN Kosovë” ka përmbushur kriteret kualifikuese për t’u pajisur me licencë të KPM-së për ofrues të shërbimeve mediale audio vizuale, në pajtim të plotë me Rregulloren KPM-2021/01.

### Vendim

9. Komisioni në takimin e datës 1 shtator 2023, merr vendim që kandidatin A2 CNN Kosovë, me seli në Prishtinë, t’i lëshoj licencën për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale përmes operatorëve të shpërndarjes, si kanal me përmbajtje programore tematike (informative), në Republikën e Kosovës.
10. Në pajtim me Nenin 21, paragrafi 2 të Ligjit për KPM-në, licenca e Ofruesit të Shpërndarjes së Shërbimeve Mediale Audiovizuale A2 CNN Kosovë do të jetë e vlefshme në një afat prej dhjetë (10) vitesh, me mundësi të ripërtëritjes sipas Nenit 25 të këtij ligji.
11. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



01.09.2023

datë